



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Ligji Nr. 06/L -061

**PËR RATIFIKIMIN E TRAKTATIT NDËRMJET REPUBLIKËS SË
KOSOVËS DHE HUNGARISË MBI TRANSFERIMIN E PERSONAVE
TË DËNUAR**

Kuvendi i Republikës së Kosovës;

Në bazë të nenit 65 (1 dhe 4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton:

**LIGJ PËR RATIFIKIMIN E TRAKTATIT NDËRMJET REPUBLIKËS
SË KOSOVËS DHE HUNGARISË MBI TRANSFERIMIN E
PERSONAVE TË DËNUAR**

Neni 1
Qëllimi

Ky ligj ka për qëllim të ratifikojë Traktatin ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Hungarisë mbi transferimin e personave të dënuar, të nënshkruar nga Ministrat e Drejtësisë së të dy vendeve, më 24 nëntor 2017, në Prishtinë.

Neni 2
Fushëveprimi

Ky ligj vlen për të gjitha organet e administratës shtetërore dhe organet gjyqësore në Kosovë që janë përgjegjëse për bashkëpunim juridik ndërkombëtar.

Neni 3
Hyrja në fuqi

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas publikimit në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

Ligji Nr. 06/L -061
04 qershor 2018

Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,

Kadri VESELI